




Pranuar / Dorezuar Priljeno / Prudato Received / Delivery	14-06	2021	1	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKRINSHOT	3058/2021		114	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

A.nr.394/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses për shqyrtimin e ankesës A.nr.394/2021 të datës 06.05.2021 kanë shqyrtuar ankesën e parashtruar nga ankuesi me adresë banimi: rr. "Fehmi dhe Xhevë Lladrovci", nr. 24, Skenderaj, kundër organit të punësimit Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, në çështjen juridike "*masë disiplinore*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim, më datë 14.06.2021 mori këtë:

**V E N D I M**

**I. REFUZOHET** si e pabazuar ankesa me numër A.nr.394/2021 e datës 06.05.2021 e parashtruar nga ankuesi

**II. MBETET** në fuqi Vendimi i datës 22.04.2021 me numër protokolli 02-0132 i Komisionit Disiplinor të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror.

**A r s y e t i m**

Ndaj ankuesit i punësuar në Agjencinë e Shërbimit të Navigacionit të Shërbimit Ajror, sipas Akt emërimit Nr.4569 të datës 15.11.2019, në pozitë „Zyrtar i Prokurimit“, në Departamentin e Prokurimit, më datë 30.03.2021 Menaxheri i Departamentit të Prokurimit ka njoftuar se dyshohet se ankuesi ka bërë shkelje të nenit 46, paragrafi 3.10 të Ligjit Nr.06/L-134 për Zyrtarët Publik. Pas inicimit të procedurës Disiplinore nga Menaxheri i Departamentit të Prokurimit, nga menaxheri i burimeve njerëzore lënda është përcjellë te Komisioni Disiplinor i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA).



Komisioni Disiplinor i ASHNA me datën 22.04.2021 ka nxjerrë vendimin me numër protokollit 02-0132 me të cilin vendim ankuesit i shqipton masën disiplinore ndalim 30 % i pagës për periudhën gjashtë (6) muaj.

Ankuesi i pa kënaqur me vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 22.04.2021 me numër protokollit 02-0132 për shqiptimin e masës disiplinore Ndalim 30% i pagës për periudhën gjashtë(6) muaj, me datën 06.05.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 2265 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendime ankimore se vërejtja me shkrim është e pabazuar.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datën 18.05.2021, e ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror. Më datë 07.06.2021 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, bashkë me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 06.05.2021 me numër protokollit 2265/2021 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 22.04.2021 me numër protokollit 02-0132 i Komisionit Disiplinor i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror; Njoftim mbi dyshimin për shkelje disiplinore i datës 19.03.2021 me numër protokollit 0104 nga menaxheri i Departamentit të Burimeve Njerëzore; E-mail zyrtar i datës 09.02.2021; Lista e nëpunësve me kërkesa të pushimeve prej datës 08.02.2021 deri më 18.02.2021; E-mail zyrtar i datës 24.02.2021 nga menaxherja e personelit në KQZ; Foto nga incidenti në KQZ; Takim i Komisionit Disiplinor i ASHNA i datës 12.04.2021; Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 15.01.2021 e nënshkruar nga Kryeshefi Ekzekutiv i SKQZ; Akt emërimi i datës 23.04.2018 i Kushtrim Fazliut; E-mail i datës 30.03.2021; Kërkesa për pushim; Dëshmi se ankuesi ka punuar në KQZ; E-mail zyrtar i datës 12.04.2021; Orari për muajin mars 2021; Orari për muajin shkurt 2021; Orari për muajin janar 2021; Hyrje-daljet janar-mars 2021; Takim i Komisionit Disiplinor i datës 12.04.2021; Intervistimi i palëve dhe Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit bashkë me shkresat e lëndës faqe 1/44.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e pabazuar sepse,*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit kundër shqiptimit të masës disiplinore, ndalim 30% i pagës për periudhën gjashtë (6) muaj me arsyetimin se Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së Vendimit të datës 22.04.2021 me numër protokollit 02-0132 ka vepruar në kundërshtim me Ligjin Nr.06/L-134 për Zyrtarët Publik dhe Rregullores(QRK)Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë .

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të provave të lëndës ka konstatuar se ankuesi prej datës 08 deri 18 shkurt 2021 ka shfrytëzuar pushimin mjekësor tek punëdhënësi ASHNA, ndërsa në të njëjtën kohë ka lidhë kontratë (Marrëveshje për shërbime





të veçanta) me punëdhënësin sekondar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve prej datës 15.01.2021 deri 15 ditë pas certifikimit të zgjedhjeve.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka shqyrtuar edhe pretendimin ankimor të ankuesit i cili deklaron se: lidhur me këtë çështje unë paraprakisht e kam njoftuar udhëheqësin tim të drejtpërdrejt gojarisht ashtu siç parashihet në nenin 29 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-134 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet se: *“Zyrtari publik ka detyrimin të informojë paraprakisht mbikëqyrësin e tij dhe njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore për çdo veprimtari me pagesë, që kryen jashtë detyrës së tij vetëm në pajtim me ligjin”*. edhe ky pretendim i ankuesit është i paqëndrueshëm sepse kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave nuk posedon asnjë provë me shkrim që e ka njoftuar mbikëqyrësin e as njësinë e burimeve njerëzore. Në seancën dëgjimore të Komisionit Disiplinor të datës 12.04.2021 menaxheri i departamentit të prokurimit ka deklaruar se nuk kam qenë i njoftuar me shkrim as gojarisht se i njëjti ka filluar të punon në KQZ, përveq shkresës se i njëjti ka qenë në pushim mjekësor. Më datën 15.03.2021, drejtori i ASHNA-së dhe Departamenti i Burimeve Njerëzore ka bërë verifikimin e nëpunësve të ASHNA-së, të cilët në të njëjtën kohë kanë qenë në pushim mjekësor dhe të angazhuar në procesin zgjedhor të 14 shkurtit 2021. Angazhimin e z. në procesin zgjedhor të 14 shkurtit 2021, e dëshmojnë edhe raportet e mediave për incidentin e shkaktuar mes z. dhe një zyrtari tjetër, e lidhur me incidentin e raportuar, i njëjti ka dhënë deklaratë në media, po ashtu ankuesi në seancën dëgjimore të Komisionit Disiplinor të ASHNA-së, ka deklaruar se ka marrë pushim mjekësor pasi ka qenë i sëmurë nga gripi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i ASHNA-së gjatë shqiptimit të masës disiplinore si rrethanë lehtësuese ka marrë vlerësimet e performancës në punë për tri vitet e fundit, të cilat vlerësime kanë qenë të kënaqshme dhe në të kaluarën edhe se nuk ka pasur ndonjë masë tjetër disiplinore.

Komisioni Disiplinor i Agjencisë të Shërbimeve të Navigacionit Ajror, në mënyrë të drejtë ka konstatuar shkeljen që ankuesi ka bërë, dhe shqiptimi i masës disiplinore 30 % të pagës për periudhën gjashtë (6) muaj sipas Vendimi i datës 22.04.2021 me numër protokolli 02-0132 i Komisionit Disiplinor i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror, andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se kjo masë është shqiptuar në bazë dispozitave të nenit 46 , paragrafi 3, 3.10 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: *“shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi”* mbi këtë bazë Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se masa disiplinore *“i ndalohej 30 % e pagës për periudhën kohore deri në gjashtë (6) muaj”*, e shqiptuar ndaj ankuesit, është në përputhje të plotë me dispozitat ligjore në fuqi, sepse është shqiptuar në raport të drejtë me shkeljen e kryer, rrjedhimisht udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit, ka vepruar në pajtim me nenin 48 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *“Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil”*, nenin 13 paragrafin 4 nën paragrafët 4.1 dhe 4.2 dhe paragrafin 5 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.





Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar dhe analizuar vendimin me nr Nr.01/2021 të datës 23.03.2021, të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ka konstatuar se: Komisioni disiplinor ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, sepse me rastin e shqiptimit të masës disiplinore: *"i ndalohej 30 % e pagës për periudhën kohore deri në gjashtë (6) muaj"*, ka marrë për bazë të gjitha faktet dhe provat që kanë shpër deri tek ky vendim.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës  
Lënda, A.nr.394/2021, datë 14/06/2021

Sabile Avdyli  
*Sabile Avdyli*  
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Drejtorit të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

